

SERIA 2:

PROFESIONI I KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT - SHTIM I VLERËS GLOBALE

Nëntor 2015



International
Federation
of Accountants®



Draftet, Dokumentet e Konsultimit dhe botime të tjera të FNK janë të botuara nga FNK dhe të drejtat e autorit i posedon FNK.

FNK nuk pranon përgjegjësi për humbjen e shkaktuar ndaj çdo personi që vepron ose përmbahet nga veprimi duke u mbështetur në materialin në këtë botim, pavarësisht nëse humbja e tillë është shkaktuar nga neglizhenca ose ndryshe.

Logo e FNK, 'Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve' dhe 'FNK' janë marka tregtare dhe marka shërbimi të FNK.

Të drejtat e autorit © Tetor 2015 nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK). Të gjitha të drejtat e rezervuara. Kërkohet leja me shkrim nga FNK për të riprodhuar, ruajtur ose transmetuar, ose për të bërë përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti, përveç siç lejohet me ligj. Kontaktoni permissions@ifac.org.

ISBN: 978-1-60815-256-8

"Pika në të cilën nevoja për mendim strategjik plotëson profesionin e kontabilitetit dhe auditimit është lidhja në të cilën vendimmarrja e duhur ndihmon në forcimin e organizatave dhe përparimin e ekonomive, në interes të publikut. "

– Fayez Choudhury, Kryeshef Ekzekutiv në FNK

Në vitin 2015, FNK angazhoi konsulentët e pavarur të ekonomisë dhe hulumtimit të biznesit - Cebr, për të analizuar të dhënat tona të anëtarësisë nga viti 2009 në 2013.

Seria 2: Profesioni i Kontabilitetit dhe Auditimit - Shtim i Vlerës Globale është raporti i dytë nga dy raportet që pasqyrojnë analizën e Cebr dhe ofron një pamje të rëndësishme të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit për ekonominë globale dhe kontributin e tij në shoqëri.

Raporti i parë, **Seria 1: Profesioni i Kontabilitetit dhe Auditimit, Prapa Numrave** botuar në Tetor 2015, dha detaje dhe njohuri prapa këtyre numrave. Ai theksoi rëndësinë e kontabilistëve profesionistë për ekonominë në rritje dhe krahasoi rritjen e profesionit me rritjen totale të punësimit brenda rajoneve. Pamja e përgjithshme tregoi një profesion të kërkuar, duke u rritur në mënyrë të qëndrueshme dhe duke dhënë kontribute të konsiderueshme në të gjitha fushat e shoqërisë.

SERIA 2: PROFESIONI I KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT - SHTIM I VLERËS GLOBALE

Një sistem më i zhvilluar ekonomik kërkon një strukturë të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit që përvetëson informacionin e nevojshëm përkatës në lidhje me produktivitetin dhe performancën e sektorëve të ndryshëm.¹



Pika në të cilën nevoja për mendim strategjik plotëson profesionin e kontabilitetit dhe auditimit është lidhja në të cilën vendimmarrja e duhur ndihmon në fuqizimin e organizatave dhe përparimin e ekonomive, në interes të publikut.

Në fillim të këtij viti, FNK njoftoi se numri i kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë të përfaqësuar nga 175 + organizatat tona anëtare në mbi 130 vende dhe juridiksione kishte arritur në 2.84 milion.

Seria 2: Profesioni i Kontabilitetit dhe Auditimit - Shtim i Vlerës Globale, pasqyron kërkime inovatore nga Cebr për të shoqëruar, për herë të parë, madhësinë dhe rritjen e profesionit me zhvillimin e ekonomive.

Studimi gjeti një korrelacion të fortë në mes numrit të kontabilistëve dhe auditorëve që punojnë në ekonomi me PBB për kokë banori, dhe një korrelacion edhe më të fortë me Indeksin e Zhvillimit Njerëzor

të BE, i cili mat indikatorët duke përfshirë jetëgjatësinë, vitet e shkollimit dhe të ardhurat.

Ndikimi i profesionit në informacion më të mirë, raportim, matjen dhe vendimmarrje është i lidhur në mënyrë të vendosur me standardet e përmirësuara të jetesës dhe shëndetit, mirëqenien dhe prosperitetin e kombeve dhe qytetarëve të tyre.

Raporti gjithashtu vlerëson se ekologjia globale e kontabilitetit dhe auditimit - përfshirë anëtarët e organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit të FNK (OPK), si dhe njerëz që identifikojnë rolet e tyre si kontabilistë dhe auditorë ose mbështetje të kontabilitetit dhe auditimit - kontribuon mbi gjysmë trilion dollarë (USD) në vit në ekonominë globale. Nga kjo shumë, anëtarët e OPK-ve të FNK kontribuojnë pothuajse mbi 43%.

Këto masa nxjerrin në pah rolin thelbësor që luajnë kontabilistët dhe auditorët në avancimin e stabilitetit ekonomik dhe rritjen në nivele të shumëfishta në të gjithë shoqërinë.

Kontabilistët dhe Auditorët kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në qëndrueshmërinë e organizatave të vogla, të mesme dhe të mëdha, tregjeve të shëndosha të kapitalit, administrimit efektiv të financave publike dhe ofrimit të shërbimeve publike, dhe - në fund - prosperitetit ekonomik të theksuar në këtë raport.

Si organizatë globale për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, FNK - përmes organizatave të saj anëtare - promovon një profesion entuziast të bazuar në baza të forta arsimore dhe etike. Ne jemi krenar që përfaqësojmë një profesion që përcaktohet nga përkushtimi i tij për interesin publik - një partner i besuar i qeverive, politikëbërësve, bizneseve dhe komuniteteve që ne i shërbejmë.

Fayez Choudhury

Kryeshef Ekzekutiv në FNK

¹ Sawani, Assma. "Ambienti në Ndryshimin e Profesionit të Kontabilitetit: Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Zbatimi i tyre në ShBA." Revista Financiare dhe e Kontabilitetit (2009).

GJETJET KYÇE



GJETJET KYÇE

1

Zhvillimi ekonomik dhe standardet e përmirësuara të jetesës janë të lidhura me një profesion të fuqishëm të kontabilitetit dhe auditimit.

Kontabilistët dhe Auditorët luajnë një rol të rëndësishëm në kaudër të interesit publik, duke punuar në të gjithë shoqërinë për të fuqizuar organizatat dhe ekonominë. Ekziston një lidhje e fuqishme në mes të një profesioni të fuqishëm, prosperitetit ekonomik dhe standardeve të përmirësuara të jetesës - duke përfshirë jetëgjatësi më të mirë, më shumë vite shkollimi dhe të ardhura më të larta.

2

Kontributi ekonomik i ekologjisë globale të kontabilitetit dhe auditimit është 575 miliardë dollarë; Anëtarët e OPK-ve të FNK kontribuojnë me 248 miliardë dollarë.

Ky kontribut i konsiderueshëm ekonomik global - i përcaktuar si vlera e shtuar bruto (VSHB) - e kontabilistëve dhe auditorëve është i krahasueshëm me kontributet nga disa ekonomi të mesme të zhvilluara. Ky kontribut është shumë i rëndësishëm për qeveritë, politikëbërësit, bizneset dhe publikun, me të cilët profesioni punon për të nxitur rritjen ekonomike dhe prosperitetin. Përtej këtij kontributi të drejtpërdrejtë, kontabilistët luajnë një rol të rëndësishëm në të gjithë shoqërinë globale duke mundësuar prodhimin dhe rritjen në të gjithë sektorët ekonomikë.

3

Kontributet më të mëdha nga Evropa dhe Amerika e Veriut; mundësitë ekzistojnë në rajone të tjera

Profesioni ofron kontributet më të mëdha ekonomike në ekonomitë e zhvilluara - veçanërisht në Evropë dhe Amerikën e Veriut. Rajonet e tjera të botës paraqesin një mundësi për të kontribuar më shumë në ekonominë globale. FNK dhe organizatat e saj anëtare janë të angazhuara në mënyrë aktive në ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e profesionit në ato rajone.

SFIDAT DHE MUNDËSITË

Ky studim ka identifikuar trendet, mundësitë dhe sfidat për profesionin global, duke përfshirë:

Roli kritik i kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë në ekonominë globale dhe kontributi i tyre ekonomik në shoqëri

FNK dhe profesioni i kontabilitetit dhe auditimit duhet të vazhdojnë të punojnë me qeveritë, politikëbërësit, rregullatorët, bizneset dhe publikun për të siguruar që kontributi i profesionit për bizneset, komunitetet dhe ekonominë të njihet dhe zhvillohet. Çfarë mund të bëjmë më shumë për të nxjerrë në pah kontributin ekonomik global të profesionit? A ekzistojnë metrika ose sisteme të ndryshme - ose të reja - që mund të përdoren në këtë përpjekje?

Rritja e profesionit në kombet në zhvillim

Profesioni është shumë i rëndësishëm për ekonomitë elastike, transparente dhe të përgjegjshme. FNK - dhe profesioni në kombet e zhvilluara - duhet të vazhdojnë të ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve në vendet në zhvillim për të mbështetur rritjen dhe stabilitetin e tyre ekonomik dhe integrimin në ekonominë globale. Tashmë është bërë shumë nga OPK-të për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve në vendet në zhvillim, por si mund ta stimulojmë rrjedhën e fondeve shtesë të zhvillimit për të mirën e profesionit?

Tërheqja e kontabilistëve dhe auditorëve si dhe edukimi dhe trajnimi i tyre brenda një profesioni global

Kontributi ekonomik global i individëve të përcaktuar si kontabilistë dhe auditorë nga statistikat kombëtare, por jo i lidhur me një OPK të FNK, është 327 miliardë dollarë. Kjo shifër thekson një mundësi domethënëse që profesioni global të jetë edhe më i koordinuar dhe me ndikim, dhe kështu të kontribuojë edhe më shumë në rritjen ekonomike dhe prosperitetin. Çfarë mund të bëjnë më shumë OPK-të për të tërhequr anëtarët në OPK? Çfarë aftësish të reja duhet të promovojë profesioni për kandidatët e mundshëm - dhe cilat aftësi të reja u duhen brezit të ardhshëm të kontabilistëve dhe auditorëve?


MIRËQENIA EKONOMIKE DHE STANDARDET E JETESËS TË LIDHURA ME MADHËSINË E PROFESIONIT TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT

Zhvillimi ekonomik, i matur nga produkti i brendshëm bruto (PBB) për kokë banori, lidhet fuqishëm me përqindjen e kontabilistve dhe auditorëve në fuqinë punëtore. Korrelacioni është më i fortë në mes ekonomive në zhvillim, dhe më i dobët në mes ekonomive më pak të zhvilluara.

Kontabilistët dhe Auditorët profesionistë mbështesin rritjen ekonomike duke promovuar transparencën dhe efikasitetin. Puna e tyre është thelbësore për krijimin dhe mbajtjen e klimës së investimeve të kërkuara për përmirësimin e produktivitetit dhe zhvillimin ekonomik. Dhe ndërsa ekonomitë rriten, ato janë në gjendje të kalojnë në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar përmes edukimit më të mirë dhe institucioneve më të fuqishme, gjë që rrit mbizotërimin e sektorit të shërbimeve - veçanërisht shërbimeve profesionale.




PBB E PËRGJITHSHME PËR KOKË BANORI DHE PËRFSHIRJA E KONTABILISTËVE DHE AUDITORËVE NË PUNËSIMIN TOTAL




MIRËQENIA EKONOMIKE DHE STANDARDET E JETESËS TË LIDHURA ME MADHËSINË E PROFESIONIT TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT

KORRELACIONI I PBB-SË PËR KOKË BANORI ME % E KONTABILISTËVE
DHE AUDITORËVE NË FUQINË PUNËTORE



● Ekonomitë e avancuara ● Ekonomitë në zhvillim ● Ekonomitë më pak të zhvilluara

KORRELACIONI I INDEKSIT TË ZHVILLIMIT NJERËZOR TË BE ME
% E KONTABILISTËVE DHE AUDITORËVE NË FUQINË PUNËTORE



● Ekonomitë e avancuara ● Ekonomitë në zhvillim ● Ekonomitë më pak të zhvilluara



Korrelacioni në mes të përqindjes së kontabilistëve profesionistë në fuqinë punëtore dhe Indeksit të Zhvillimit Njerëzor të BE - i cili mat një numër indikatorësh duke përfshirë jetëgjatësinë, vitet e shkollimit dhe të ardhurat dhe është më i gjerë se PBB - është edhe më i fuqishëm.

Këto marrëdhënie tregojnë rëndësinë e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit për zhvillimin ekonomik kombëtar dhe standardet përkatëse të jetesës. Profesionit luan një rol thelbësor në avancimin e stabilitetit dhe rritjes ekonomike - përmes informacionit, raportimit, matjes dhe vendimmarrjes të duhur - që lidhet në mënyrë të vendosur me përmirësimin e standardeve të jetesës dhe pasurinë dhe prosperitetin e kombeve dhe qytetarëve të tyre.


PROFESIONI I KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT GLOBAL OFRON NJË KONTRIBUT TË KONSIDERUESHËM EKONOMIK

Kontributet ekonomike shpesh përshkruhen në termat e "vlerës së shtuar bruto" (VSHB) - duke folur afërsisht, shumën e kompensimit të punonjësve, fitimet, tepricat dhe tatimet mbi prodhimin.

\$575 MILIARDË: VLERËSIMI I VSHB TË EKOLOGJISË GLOBALE TË KONTABILITETIT DHE


AUDITIMIT. Kjo tejkalon VSHB-në totale të shumë vendeve të zhvilluara, të mesme.

VLERA VJETORE E SHTUAR BRUTO (VSHB)



Australasia, me relativisht pak kontabilistë dhe auditorë dhe Lindja e Mesme dhe Afrika, me vlerë të shtuar relativisht më të vogël, kanë rreth gjysmën e VSHB të lidhur me kontabilitetin dhe auditimin e Amerikës së Jugut dhe Azisë.

VLERA VJETORE E SHTUAR BRUTO (VSHB) E ANËTARËVE TË OPK-VE TË FNK (2013)




VSHB e OPK-ve të FNK anëtarët përafërsisht gjithsej

\$248 MILIARDË

ose rreth **43%** e ekologjisë së kontabilitetit dhe auditimit global

Tre të katërtat e kësaj "VSHB-FNK" vlerësohet se vijnë nga Amerika e Veriut dhe Evropa. Australasia është kontribuesi i tretë më i lartë për VSHB. Profesionit i kontabilitetit dhe auditimit është unik për sa i përket organizimit të tij global dhe respektimit të gjerë të standardeve profesionale të pranuar ndërkombëtarisht. Kontributi ekonomik i anëtarëve të OPK-ve të VSHB do të vazhdojë të rritet së bashku me profesionalizimin dhe përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve.





International
Federation
of Accountants®